



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL DURRËS

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Riparime dhe zgjerim sheshi me të gjitha aksesoret e infrastrukturës civile pas Kalatës nr. 1 dhe në sheshin pas Kalatës nr. 0” (Procedurë e Hapur e Thjeshtuar- Pune) – kontratë me çelësa në dorë

VLERA E FONDIT LIMIT: 11,839,839 (njemdhjetë milion e teteqind e tridhjetë e nente mijë e teteqind e tridhjetë e nente) lekë, pa Tvsh

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Shërbime për projektim të arkitektures 71220000-6
- Shërbim për projektim ndërtesash 71221000-3
- Përgatitje për projektim dhe dizajn, vlerësim i kostos 71242000-6
- Punime ndërtimi 45210000-2
- Punime betoni 45262300-4
- Sinjalistikë 34928470-3
- Punime riparim betoni 45262330-3

- Afati për përfundimin dhe dorëzimin e projektit të zbatimit është **20 ditë** kalendarike nga data e lidhjes së kontratës.
- Afati për realizimin e punimeve të zbatimit është **45 ditë** kalendarike nga data e njoftimit për fillimin e punimeve.

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar.

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (sipas shtojcës 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 39, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre vitet e fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të viteve financiare duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c e 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit Udhëzim i Përgjithshëm. nr. 26, datë 8.9.2023 për tatimin mbi të ardhurat, Ligj nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 30% e vlerës së përllëgoaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se fondi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i

përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe në nenet 55, pika 4 a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Liçensat profesionale ne projektim

Subjektet pjesëmarrëse kërkohen të zotërojnë, Liçenca ne Projektim, referuar Vendimit nr. 943, Date 28. 12. 2016, për “Liçencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikeqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”:

- Projektues konstruktor – Kat 3, pika a, projektim objekte civile industrial turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kat.
- Projektues Rruge – Kat 6, pika a, rruge urbane dytesore
- Projektues gjeodet –Kat 8, pika a, rilevime inxhinjerike
- Projektues te sinjalizimit rrugor – Kat 11, pika a, Projektim sinjalistike jondircuese ne rruge lokale, rruge urbane dytesore.

Individët apo personat juridik të cilët disponojnë liçenca të cilat nuk janë në përputhje me pikat e Lidhjes 2 “Kategorite në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim”, të V.K.M. nr. 943, datë 28. 12. 2016, duhet të bëjnë rinovimin dhe ekuivalentimin e tyre. Në rastin e mosparaqitjes së liçencave, ofertuesit nuk do të merren në konsideratë për kualifikim.

Duhet të dorëzohet liçenca në projektim e shoqërisë si dhe liçenca individuale e drejtuesit teknik me pikat përkatëse. Në rastin kur subjekti që ushtron veprimtari në fushën e projektimit është person fizik të paraqitet vetëm liçenca profesionale personale në projektim për pikat e kerkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a dhe pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 943, Date 28. 12. 2016, për “Liçencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të

ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

2.3.3 Mbi certifikimet e kompanisë së projektimit

- Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të cilësive (ISO 9001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).

Shënim: Çertifikatat e mësiperme/ekuivalentet duhet të jenë të lëshuara nga Institucione të certifikuara/akredituara në Shqipëri ose tek ato ndërkombetare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këto certifikata.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, është një standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, i ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.4 Liçencat profesionale në zbatim të punimeve të ndërtimit

Subjektet zbatuese, pjesëmarrëse në konkurim duhet të zotërojnë, Liçenca profesionale të Zbatimit, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”:

- N.P – 1 Punime gjurmimi në tokë,
- N.P – 4 Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale, për punimet rrugore, shtresat asfaltike, korsitë, sheshet dhe infrastrukturën rrugore të portës.
- N.P – 7 Ujësjellës, kanalizime,
- N.S – 1 Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S – 6 Sinjalistika rrugore jo ndriçuese, për sinjalistikën horizontale dhe vertikale.
- N.S – 18 Punime topogjeodezike

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik, liçencat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet liçenca profesionale.

Liçencat duhet të jenë të paraqitura dhe të plotësohen nga liçenca e subjektit si dhe të gjitha pikat e sipërpërmendura të cilat jepen edhe për individë duhet të përmbushen nga shumatorja e pikave të liçencave individuale të stafit inxhinierik i cili në rastin e shpalljes fitues së shoqërisë do të jetë stafi inxhinierik i realizimit të punimeve.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, të Republikës së Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar.

2.3.5.1 Mbi certifikimet e kompanisë per shoqërinë e zbatimit

- Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te cilesise (ISO 9001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te mjedisit (ISO 14001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (ISO 45001:2018) ose ekuivalente (e vlefshme).

Shënim: Çertifikatat e mësipërme/ekuivalentet duhet të jenë të lëshuara nga Institucione të certifikuara/akredituara në Shqipëri ose tek ato ndërkombetare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojnë këto certifikata.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë dhe sigurinë e informacionit janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.6 Operatorët ekonomikë pjesmarrës duhet të jenë të pajisur me licensë lëshuar nga QKL , Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta) së bashku me aktin e miratimit dhe kodet 17 01 01, 1705 04, 17 09 04 në përputhje me parashikimet e VKM nr.538 datë 26.05.2009 “Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të disponojnë licensë të vlefshme në fushën III.2.B, për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve jo të rrezikshme, së bashku me aktin përkatës të miratimit dhe kodet e mbetjeve 17 01 01, 17 05 04 dhe 17 09 04, është e lidhur

drejtpërdrejt dhe proporcionalisht me objektin e prokurimit për realizimin e punimeve të ndërtimit të objektit të prokurimit dhe preventivin e punimeve.

Gjatë zbatimit të këtyre punimeve parashikohet krijimi i mbetjeve të ndërtimit, përfshirë mbetje betoni, dhera dhe gurë nga gërmimet, nivelimet apo zëvendësimet e shtresave, si dhe mbetje të përziera të krijuara nga proceset e ndërtimit. Këto mbetje përfshihen përkatësisht në kodet 17 01 01 “Beton”, 17 05 04 “Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në kodin 17 05 03” dhe 17 09 04 “Mbetje të përziera nga ndërtimi dhe prishjet.

Në zbatim të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, transporti i mbetjeve mund të kryhet vetëm nga persona/subjekte që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e tyre. Ligji përcakton se kjo licencë përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të sistemit të licencimit, pas miratimit nga Ministria e Mjedisit. Kjo kërkesë synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë kapacitet ligjor dhe teknik për:

- 1. grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të krijuara në kantier;*
- 2. transportimin e tyre me mjete të përshtatshme dhe të autorizuar;*
- 3. pajisjen dhe administrimin e dokumentacionit të transferimit të mbetjeve;*
- 4. dërgimin e mbetjeve vetëm në subjekte, impiante ose vende pritëse të autorizuar;*

Rëndësia e kriterit është më e lartë në një ambient portual, ku depozitimi i pakontrolluar, shpërndarja apo transportimi i pasigurt i mbetjeve mund të ndikojë drejtpërdrejt në mjedisin detar, rrjetin e drenazhimit, zonat operative, sigurinë e qarkullimit të mjeteve dhe vazhdimësinë e veprimtarisë portuale. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të sigurohet që mbetjet e krijuara gjatë punimeve të mos mbeten në kantier, të mos depozitohen në mënyrë të parregullt dhe të transferohen në destinacion të ligjshëm.

Kërkesa është në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës si dhe me preventivin e saj, pasi vendos një kusht të lidhur me objektin e kontratës, dhe lidhet me një detyrim ligjor që lind nga vetë krijimi dhe transportimi i mbetjeve gjatë zbatimit të punimeve. Ajo garanton përmbushjen e përgjegjësiave mjedisore të kontraktorit, shmangjen e riskut të ndotjes dhe të sanksioneve administrative nga organe mjedisore dhe ligjzbatuese ndaj AK, si edhe realizimin e punimeve në përputhje me kërkesat e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Për sa më sipër, paraqitja e licencës III.2.B, e vlefshme për kodet 17 01 01, 17 05 04 dhe 17 09 04, vlerësohet kriter i nevojshëm, i arsyeshëm dhe proporcional me natyrën, volumen dhe riskun mjedisor të punimeve objekt prokurimi.

2.3.7 Stafi i projektimit

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, për pikat e licencave që kërkohen në projektim për shoqërinë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, liçence profesionale personale, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për liçencat profesionale individuale, apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas

parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Kriteret mbi fuqinë punëtore, të nevojshme përmbushen me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.8 Stafi ne zbatim

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, **drejtues teknik**, të figurojë në liçencën e shoqërisë, për pikat e liçencave që kërkohen në zbatim për shoqërine, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

1. Të paktën 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
2. Të paktën 1 (një) Inxhinier Mekanik
3. Të paktën 1 (një) Inxhinier Gjeolog
4. Të paktën 1 (një) Inxhinier Gjeodet

Kriteret mbi fuqinë punëtore, të nevojshme përmbushen me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në

shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mekanik, gjeolog dhe gjeodet është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve në lidhje me vendodhjen dhe strukturën e kantierit të propozuar e cila është superstrukturë detare, shesh dhe zonë operationale mbi pilota detarë dhe me nënshtresa e shtresa të projektuara dhe ndërtuara gjeologjikisht sipas kriterëve të përcaktuara për këto struktura detare. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Kërkesa për disponimin e një Inxhinieri Ndërtimi në stafin teknik të operatorit ekonomik justifikohet nga natyra dhe kompleksiteti i punimeve objekt kontrate, të cilat përfshijnë riparimin e sheshit me beton dhe realizimin e sinjalistikës përkatëse në të.

Punimet e ndërtimit kërkojnë njohuri dhe kompetenca specifike profesionale për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e proceseve të zbatimit, verifikimin e cilësisë së materialeve, respektimin e parametrave teknikë të projektit, si dhe garantimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së veprës. Gjithashtu, realizimi i sinjalistikës kërkon kontroll teknik për sigurimin e përputhshmërisë së saj me standardet dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Për rrjedhojë, prania e një Inxhinieri Ndërtimi është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të punimeve, respektimin e kërkesave teknike dhe cilësore të kontratës, si dhe përmbushjen e objektivave të investimit në përputhje me standardet në fuqi. Kjo kërkesë është në raport dhe proporcionalitet me objektin e prokurimit dhe synon sigurimin e kapaciteteve teknike të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Prania e një Inxhinieri Mekanik në stafin teknik të kontraktuesit është e nevojshme për shkak të natyrës së veçantë të punimeve në ambiente portuale-detare, ku sheshet e armuara me beton nuk i nënshtrohen vetëm ngarkesave të zakonshme të qarkullimit, por edhe ngarkesave të larta dinamike dhe të përqendruara nga mjetet e rënda portuale, pajisjet ngritëse, kamionët, trailer-at, reach stacker-at, forklift-et, vinçat dhe pajisje të tjera të operimit portual.

Inxhinieri Mekanik siguron kontrollin teknik të pajisjeve dhe makinerive të angazhuara gjatë zbatimit të punimeve, duke përfshirë eskavatorët, fadromat, cilindrat ngjeshës, pompat e betonit, vinçat, makineritë e prerjes dhe përpunimit të hekurit, gjeneratorët, kompresorët dhe mjetet e tjera ndihmëse. Ky rol është i rëndësishëm për verifikimin e gjendjes teknike, kapaciteteve të punës,

mirëmbajtjes parandaluese dhe përdorimit të sigurt të tyre, me qëllim shmangien e defekteve, ndërprerjeve të punës dhe aksidenteve në kantier.

Roli i tij është i lidhur edhe me koordinimin e punimeve pranë zonave operative të portit, ku lëvizin mjete me tonazh të lartë dhe pajisje të specializuara. Ai vlerëson ndërveprimin ndërmjet sheshit të realizuar dhe ngarkesave që do të transmetohen nga pajisjet portuale, duke ndihmuar në garantimin që zgjidhja e ndërtimit të jetë funksionale, e sigurt dhe e qëndrueshme gjatë shfrytëzimit.

Për më tepër, Inxhinieri Mekanik kontribuon në hartimin dhe zbatimin e masave të sigurisë teknike në punë, veçanërisht për përdorimin e makinerive të rënda, ngritjen dhe transportin e materialeve, operimet me pajisje nën presion, energji elektrike të përkohshme dhe punime pranë infrastrukturës aktive portuale.

Për sa më sipër, kërkesa për Inxhinier Mekanik është e justifikuar dhe proporcionale me objektin e kontratës, pasi garanton kontroll të specializuar mbi makineritë, pajisjet, ngarkesat operative dhe kushtet e veçanta të mjedisit detar, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë, sigurinë, afatet e realizimit dhe jetëgjatësinë e investimit.

Angazhimi i një Inxhinieri Gjeolog në zbatimin e punimeve për ndërtimin e shesheve të armuara me beton në ambiente portuale-detare është i nevojshëm për shkak të kushteve të veçanta gjeologjike, gjeoteknike dhe hidrogjeologjike që karakterizojnë zonat bregdetare dhe portuale.

Inxhinieri Gjeolog nevojitet për të verifikuar karakteristikat reale të truallit gjatë punimeve dhe për të kontrolluar përputhshmërinë e tyre me projektin dhe studimin gjeologo-inxhinierik.

Roli i tij është veçanërisht i rëndësishëm në kontrollin e punimeve të gërmimit, zëvendësimit të shtresave të papërshtatshme, mbushjeve, nivelimit dhe përgatitjes së nënbazës. Ai vlerëson cilësinë e materialeve të përdorura për mbushje dhe stabilizim, përbërjen granulometrike, lagështinë, shkallën e ngjeshjes dhe aftësinë mbajtëse të shtresave para realizimit të pllakës së betonit.

Inxhinieri Gjeolog siguron gjithashtu dokumentimin teknik të kushteve të truallit të evidentuara gjatë zbatimit, identifikon ndryshimet ndërmjet situatës së projektuar dhe asaj faktike në terren dhe rekomandon ndërhyrje korrigjuese kur evidentohen shtresa të dobëta, materiale të papërshtatshme, nivel i lartë ujërash apo kushte të tjera që mund të cenojnë cilësinë dhe sigurinë e investimit.

Për sa më sipër, kërkesa për një Inxhinier Gjeolog është e justifikuar dhe proporcionale me objektin e kontratës, pasi garanton kontrollin e cilësisë së truallit, stabilitetin e shtresave bazë, menaxhimin e riskut nga ujërat nëntokësore dhe kushtet detare, si dhe jetëgjatësinë e shesheve të armuara me beton në funksion të operimeve portuale.

Kërkesa e një Inxhinieri Gjeodet në zbatimin e punimeve për ndërtimin e shesheve të armuara me beton në ambiente portuale-detare është i nevojshëm për garantimin e saktësisë së planvendosjes së kuotave, pjerrësive dhe përputhshmërisë së punimeve me projektin e miratuar.

Sheshet portuale kanë kërkesa të larta funksionale, pasi shërbejnë për lëvizjen dhe operimin e mjeteve të rënda, pajisjeve të ngarkim-shkarkimit, kamionëve, trailer-ave, vinçave portualë, reach stacker-ave dhe mjeteve të tjera të specializuara. Çdo devijim në kuota, rrafshësi ose pjerrësi mund të krijojë probleme në kullimin e ujërave, në stabilitetin e pajisjeve, në sigurinë e qarkullimit dhe në jetëgjatësinë e pllakave të betonit.

Ai nevojitet gjithashtu për monitorimin e deformimeve dhe uljeve të mundshme gjatë dhe pas realizimit të punimeve, sidomos në zona me mbushje, truall të ngjeshur artificialisht ose pranë

strukturave portuale ekzistuese. Në rast se evidentohen devijime nga kuotat e projektuara, ulje lokale ose mosrespektim i rrafshësisë, Inxhinieri Gjeodet mundëson marrjen në kohë të masave korrigjuese përpara përfundimit të shtresave përfundimtare të betonit.

Për sa më sipër, kërkesa për Inxhinier Gjeodet është e justifikuar dhe proporcionale me objektin e kontratës, pasi siguron kontroll të vazhdueshëm topografik të punimeve, respektimin e projektit, realizimin e saktë të kuotave dhe pjerrësive, funksionimin e drenazhimit, koordinimin me infrastrukturat ekzistuese dhe cilësinë përfundimtare të shesheve të armuara me beton në ambient portual-detare.

2.3.9 Numri i punonjësve

Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të stafit për realizimin dhe zbatimin e shërbimit. Numri i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më i vogël se 22 punonjës për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertës.

Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

-Vërtetim nga Administrata Tatimore, si edhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/SIG-25, për të gjithë periudhën e kërkuar.

-Operatori ekonomik duhet të deklarojë disponibilitetin e numrit të kërkuar të punonjësve për gjatë gjithë periudhës së realizimit të shërbimit, konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Kriteret mbi fuqinë punëtore, të nevojshme përmbushen me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- 2 **Argumentimi:** Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje gjashtë muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore).

2.3.10 Specialistet

Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit të tij, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë ofertuese, për të gjithë periudhën e kërkuar, të paktën:

- 1 (një) Teknik Ndërtimi,
- 6 (gjashtë) punëtor të thjeshtë
- 1 (një) manovrator ruli..
- 1 (një) manovrator fadrome ...
- 4 (trë) punëtorë betoni
- 1 (një) drejtues betoniere
- 6 (gjashtë) punëtorë ndihmës
- 2 (dy) saldatorë për punime speciale saldimi

Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik, kontratat e punës të vlefshme, një dokument që të vertetojë kualifikimin profesional (deshmi kualifikimi profesional / certificate / diplome) leshuar nga institucione të licensuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore sipas ligjit nr.15/2017 Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise” dhe deshmi e sigurimit teknik leshuar nga ISHTI (punonjes elektrikist te pajisur me libreza te grupit te sigurimit teknik 3 ose 4) ose nga një trup certifikues e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akredituese të njohur nga Republika e Shqiperise si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Saldatorët për punime speciale saldimi sipas EN 9606:1 me certifikatë të vlefshme dhe leshuar nga institucionet të akredituara e të njohura në Republikën e Shqipërisë dhe të figurojë në listeoagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

***Argumentimi:** Kjo kerkese eshte vendosur bazuar ne nenin 77/4 te ligjit nr. 162/2020, Per prokurimin publik, i ndryshuar, e cila ka lidhje teknike me objektin qe prokurohet dhe eshte proporcionale me objektin e kontrates. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe*

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës

2.3.11 Siguria dhe shendetit ne pune

Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës, pajisur me certifikatë për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplome/certifikate.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplome/certifikate.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentim: Kjo kërkesë është në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune", e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.

2.3.12 Mjete dhe paisje

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Lloji Makinerive</i>	<i>SASIA</i>	<i>PRONESIA</i>
<i>Ekskavator me goma</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamion vetëshkarkues</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rul vibrues</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rul dore</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

<i>Auto Betoniere me pompe</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibratorë betoni</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
LLOJI I PAISJEVE	SASIA	PRONESIA
<i>Gjenerator korenti</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kompresor</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Prerese betoni elektrike</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makineri për vijëzim horizontal</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar.

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore).

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor apo nënligjor, në bazë të të cilit është bërë përlllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjetet/makineritë/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës).

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punimet objekt prokurimi, duke përllogaritur sasishtë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe nderkombëtare, në përputhje me parashikimet e nenit 4 ,pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 39 ,pika 2, të VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson punimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose**

performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

KOMISIONI I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
PERLLOGARITJES SE VLERES SE FONDIT LIMIT

KRYETAR
Rafaelo REXHO

ANËTAR
Evis QYRKU

ANËTAR
Gjergj KOTA

ANËTARE
Vilma SHEHU